



Vaksinimet e rekomanduara për disa nga fëmijët

Të gjithë fëmijët në Suedi kanë të drejtë për t'u vaksinuar ndaj nëntë sëmundjeve serioze (shih fletën e informacionit, Programi suedez i vaksinimit për fëmijë). Të gjitha vajzave ju ofrohet vaksinimi ndaj virusit papillomvirus human, (shih fletën e informacionit Vaksinimi ndaj HPV për vajzat). Disa prej fëmijëve, përveç kësaj ju ofrohet edhe vaksinimi ndaj hepatitit B, tuberkulozit, gripit dhe infeksionit nga pneumokokët.

HEPATITI B

Hepatiti B është një virus i cili shkakton inflamacion të mëlçisë, i cili përhapet përmes gjakut dhe lëngjeve të tjera të gjakut. Tek disa njerëz, kjo sëmundje nuk hetohet fare, kurse të tjerët sëmuren keq, për disa muaj. Shumica shërohen përsëri, por tek disa njerëz mbetet virusi edhe më tutje në trup dhe shumë më vonë, mund të shkaktojë dëmtime të mëlçisë ose kancer të mëlçisë. Rreziku është më i madh nëse infektohen si fëmijë.

Cilët duhet të vaksinohen?

Vaksinimi rekomandohet për fëmijët me rrezik të shtuar për infeksionin. Kjo, para së gjithash vlen për fëmijët që kanë anëtar të familjes me hepatitin B ose fëmijë, prindërit e të cilëve vijnë nga një shtet ku hepatiti B është më i zakonshëm në Suedi. Shumica e Këshillave të Qarqeve kanë zgjedhur t'u ofroj të gjithë fëmijëve vaksinim ndaj hepatitit B.

Çfarë mbrojtje jep vaksinimi?

Vaksinimi është shumë efikas dhe gati të gjithë fëmijët të cilët vaksinohen, zhvillojnë një mbrojtje të mirë. Mbrojtja besohet se është e mjaftueshme për tërë jetën.

Kur jepet vaksinimi?

Vaksinimi jepet zakonisht në tri raste, ose së bashku me vaksinat e tjera, gjatë vitit si foshnje) në moshën 3, 5 dhe 12 muajsh) ose sipas një orari individual.

Çfarë pasojash anësore ka?

Shumica e fëmijëve nuk kanë fare pasoja anësore ose vetëm pasoja të lehta anësore nga vakcina ndaj hepatitit B. Pasojat eventuale anësore kalojnë zakonisht brenda disa ditëve.

Këto pasoja anësore janë raportuar:

Të rralla (shihet tek më shumë se 1 nga 100 të vaksinuarve): skuqje, ënjtje dhe dhembje në vendin e injektimit.

Të rralla (më pak se 1 nga 1 000 të vaksinuarve): ethe, kruarje, dhembje të kokës, vjellje, diarre, puçrra dhe reagim alergjik.

TUBERKULOZI

Tuberkulozi është një infeksion i cili shkaktohet nga një bakterie e cila përhapet përmes ajrit kur kollitesh. Kjo zakonisht sulmon mushkëritë, por edhe organet e tjera mund të pësojnë nga kjo. Sëmundja zhvillohet ngadalë, në shumicën e rasteve, me kollitje për një kohë të gjatë, rënie në peshë dhe ethe, por mund të rri duke pushuar në trup, për shumë vite, për të shpërthyer më vonë. Tuberkulozi në formën duke pushuar nuk është ngjitëse.

Cilët duhet të vaksinohen?

Vaksinimi rekomandohet për fëmijët, familja e të cilëve vijnë nga një vend ku tuberkulozi është më e zakonshme se sa në Suedi.

Çfarë mbrojtje jep vaksinimi?

Fëmijët janë mirë të mbrojtur nga vakcina ndaj tuberkulozit të rëndë. Efikasiteti mbrojtës zvogëlohet me kalimin e viteve.

Kur jepet vaksinimi?

Vaksinimi jepet zakonisht si një dozë një herësh, nga gjashtë muaj, por mund të jepet edhe më herët, nëse rreziku për infektim është i madh.

Çka ndodhë pas vaksinimit?

Vaksinimi shkakton një infeksion të lehtë të lëkurës dhe dy deri në katër javë pas vaksinimit krijohet një kallo në vendin e injektimit. Kalloja rritet dhe skuqet dhe pas një kohe krijohet një plagë nga e cila mund të rrjedh qelb. Plagën nuk duhet ngacmuar dhe ajo shërohet zakonisht vetvetiu, pas disa javësh. Duhet shmangur të lahesh në pishinë, përderisa plaga është e hapur. Disa fëmijëve nuk ju krijohet kurrë një plagë, por vetëm një kallo e cila zhduket pas disa muajve. Çfarë pasojash anësore ndodhin?

Çfarë pasojash anësore ndodhin?

Këto pasoja anësore janë raportuar:

Të rralla (shihet tek më pak se 1 nga 1 000 të vaksinuarve): një plagë jonormale të madhe e cila merr një kohë të gjatë për t'u shëruar, ethe, dhembje të kokës dhe reagim alergjik.

GRIP

Gripi është një infeksion i kanaleve të frymëmarrjes i shkaktuar nga virusi. Kjo përhapet përmes ajrit, kur një person i sëmurë kollitet dhe teshtitet. Çdo dimër përsëritet gripi dhe në mes dy dhe pesë për qind të popullatës zakonisht sëmurën. Gripi kalon zakonisht vetvetiu, por shkakton edhe inflamacion të mushkërive

Cilët duhet të vaksinohen?

Fëmijët që i përkasin grupeve të rrezikuara ju rekomandohet të vaksinohen ndaj gripit të stinës. Vaksina ndaj gripit prodhohet nga virusi i cili kultivohet në vezë të pulave, ashtu që ai/ajo që është tejet alergjik ndaj vezëve, më parë duhet të flet me mjekun.

Sa kohë je i/e mbrojtur?

Meqenëse virusi i gripit ndryshon gjatë gjithë kohës, duhet në prag të çdo stine të prodhohet një vaksinë e re e cila vepron ndaj viruseve aktual, mu në atë kohë. Mbrojtja bie brenda një viti dhe duhet të vaksinohesh çdo vit.

Kur jepet vakcina?

Fëmijët mund të vaksinohen nga mosha gjashtë mujore. Zakonisht me një apo dy doza, varësisht nga mosha e fëmijës. Nëse përdoren dy doza, ato jepen me interval katër javor.

Çfarë pasojash anësore ka?

Shumica e fëmijëve nuk kanë fare ose kanë vetëm pasoja të lehta anësore nga vaksinimi ndaj gripit. Pasoja anësore eventuale zakonisht kalojnë brenda disa ditësh. Këto pasoja anësore janë raportuar:

Të zakonshme (shihet tek më shumë se 1 nga 100 të vaksinuarve): skuqje, ënjtje dhe dhembje në vendin e injektimit, ethe.

Të rralla (më pak se 1 nga 1 000 të vaksinuarve): reagim alergjik.

PNEUMOKOKËT

Pneumokokët janë baktere të cilat mund të shkaktojnë infeksione të lehta si inflamacion të veshëve dhe sinuseve, por ato, po ashtu, shkaktojnë sëmundje shumë serioze, si inflamacion të mushkërive, helmim të gjakut dhe inflamacion të cipës së trurit. Ekziston edhe rreziku i komplikimeve, p.sh. lloje të ndryshme të lëndimeve të trurit.

Cilët duhet të vaksinohen?

Vaksinim i përgjithshëm i foshnjave ndaj pneumokokëve, aplikuar më 1 janar 2009. Të gjitha foshnjave ju ofrohet pra vaksinim falas, gjatë vitit të parë të jetës së tyre.

Si fëmijët e vaksinuar dhe jo të vaksinuarit të cilët rrezikojnë të sëmurën rëndë nga pneumokokët, kanë nevojë edhe për më shumë vaksinime, pavarësisht moshës. Kjo vlen për fëmijët me imunitet të zvogëluar ose me sëmundje kronike, që janë rrezik i shtuar për sëmundje serioze.

Çfarë mbrojtje jep vaksinimi?

Vaksinimi jep një mbrojtje të mirë ndaj sëmundjes serioze nga pneumokokët që shkaktohet nga ato lloje të pneumokokëve që përfshihen në vaksinën përkatëse.

Kur jepet vaksinimi?

Fëmijët që i përkasin grupeve të rrezikuara vaksinohen sipas një orari individual.

Çfarë pasojash anësore ka?

Shumica e fëmijëve nuk kanë fare, ose vetëm pasoja të lehta anësore nga vakcina ndaj pneumokokëve. Pasoja eventuale anësore, kalojnë zakonisht brenda disa ditëve. Këto pasoja anësore janë raportuar:

Të zakonshme (shihet tek më shumë se 1 nga 100 të vaksinuarve): skuqje, ënjtje dhe dhembje në vendin e injektimit, ethe, diarri, vjellje..

Të rralla (më pak se 1 nga 1 000 të vaksinuarve): reagim i tejskajshëm i ndjeshmërisë, kruarje, ngërç ethesh, hithër puçrra, zbehje, plogështi.

KI PARASYSH!

Para vaksinimit: Trego që fëmija yt është i sëmurë, ka një sëmundje të fshehur ose alergji, ose ka reaguar në ndonjë mënyrë në lidhje me një vaksinim të mëhershëm.

Pas vaksinimit: Nëse fëmija duket se është keq pas vaksinimit, ti duhet të kontaktosh Qendrën shëndetësore për fëmijë, Shëndetin e nxënësve në shkollë ose kujdesin shëndetësor. Personeli i kujdesit shëndetësor duhet të raportoj reagimet të cilat vijnë në lidhje me vaksinimin, pavarësisht nëse ato varen nga vaksinimi apo jo.

Ki kujdes të dish për vaksinimet e fëmijës tënd përmes kartësBVC ose librit a në ndonjë mënyrë tjetër.



Folkhälsomyndigheten
PUBLIC HEALTH AGENCY OF SWEDEN